

**KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN
NGA RREZIQET INXHINJERIKE**
(Constructors All Risks, CAR)

Neni 1, Përcaktim të Përgjithshme

- 1.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës për sigurimin nga rreziqet inxhinjerike këtu e më poshtë do të quhen "Kushtet e Sigurimit".
- 1.2 Shoqëria e sigurimit ALBSIG SHA, këtu e në vazhdim do të quhet Siguruesi;
- 1.3 Personi juridik i licencuar për ushtrimin e veprimtarive inxhinjerike dhe personi fizik, interesi pasuror i të cilëve mbi objektin e siguruar mbulohet sipas këtyre kushteve të Sigurimit, këtu e më poshtë do të quhet "I Siguruari".
- 1.4 Personi fizik, i cili nënshkruan kontratën dhe paguan primin e sigurimit në emër dhe për llogari të Siguarit, këtu e më poshtë do të quhet "Kontraktuesi".
- 1.5 Dëshmia për lidhjen e Kontratës së Sigurimit nga të gjitha rreziqet në ndërtim, këtu e më poshtë do të quhet "Polica e Sigurimit".
- 1.6 Objekti i mbulimit në sigurim janë "**të gjitha rreziqet inxhinjerike**", përveç atyre të përjashtuara shprehimisht, të cilat shkaktojnë:
 - dëme ose humbje në materiale ndërtimi si dhe projekte inxhinjerike në ndërtim, të tilla si: shtëpi dhe ndërtesa banimi, objekte jo-rezidenciale (zyra, spitale, teatro e objekte të tjera social-kulturore) fabrika, uzina, uzina energjie (TEC-et dhe H/C-et), rrugë, hekurudha, aeroporte, ura, diga, tunele, sisteme ujitjeje, sisteme dranazhimi, kanale, porte etj., të cilat janë në pronësi të të Siguarit ose të poseduara ligjërisht nga i Siguruari në funksion të ushtrimit të aktivitetit të tij, përfshirë edhe kostot për lëvizjen e mbeturinave nga sheshi i ndërtimit.
 - dëme ose humbje të shkaktuara gjatë punës përgatitore në sheshin e ndërtimit, vendosjes dhe montimit të makinerive apo pajisjeve të ndërtimit, të ngrëhinave provizore për strehimin e punëtorëve dhe depozitim të materialeve në sheshin e ndërtimit etj.;
 - dëme ose humbje në makineri dhe pajisje të përdorura për montim dhe ndërtim;
 - dëme të shkaktuara drejtpërdrejt shëndetit dhe pronës së palëve të treta nga ushtrimi i veprimtarisë së ndërtimit/montimit, të cilat përbëjnë përgjegjësinë civile të Siguarit të vërtetuar nga gjykata (përfshirë shpenzimet gjyqësore të paguara nga i Siguruari paditësve ose të autorizuar nga Siguruesi);
 - fitimin e munguar të planifikuar të Siguarit, në vijim të dëmeve dhe/ose humbjeve nga rreziqet e mbuluara nga këto Kushte Sigurimi.

Neni 2, Objekti i kontratës

Objekt i kontratës për sigurimin nga të gjitha rreziqet inxhinjerike është marrëdhënia kontraktore në të cilën Siguruesi mbulon dëmet dhe përgjegjësitë civile të Siguarit, përkundrejt pagimit të primit dhe plotësimit të detyrimeve të kontratës nga i Siguruari.

Neni 3, Mbulimi i rreziqeve të veçanta

- 3.1 Rreziqet e mëposhtme do të mbulohen vetëm me marrëveshje të palëve (kushteve të veçanta të çdo shtojcë) si dhe kundrejt pagimit të një primi shtesë:
 - greva, kryengritja dhe turbullirat civile;
 - pagat shtesë për punën jashtë orarit, punën natën, punën në ditët e pushimit zyrtar, transporti i shpejtë;
 - pagesat shtesë për transportin ajror;
 - projektimi i gabuar;

- 3.2 Rreziqet e përcaktuara më poshtë mbulohen sipas kushteve të veçanta të përcaktuara në shtojcë, pa pagimin e primit shtesë:
 - tërmeti;
 - vërshimi dhe përmbytja;
 - dëmtimi në ndërtimin e tuneleve dhe galerive provizore;
 - dëmtimi i kabllave dhe/ose tubacioneve nëntokësore;
 - dëmtimi i të korrave, kulturave bujqësore dhe pyjeve;
 - dëmtimi në ndërtimin e digave dhe rezervuarëve të ujit provizore;
 - dëmtimi i makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit;
 - dëmtimi në materiale të ndërtimit;
 - masat mbrojtëse për rreshjet, vërshimet dhe përmbytjet;
 - lëvizjen e mbeturinave nga rrëshqitja e tokës;
 - dëmtimi në mjetet mbrojtëse kundër zjarrit;
 - shtrimi i tubacioneve të ujit.

Neni 4, Rreziqet e përjashtuara nga mbulimi

4.1 Përjashtime të përgjithshme

Ky sigurim nuk mbulon dëmet të cilat shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt:

- 4.1.1 nga aktet e qëllimshme ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguarit, të punësuarve dhe të afërmeve të tij;
- 4.1.2 nga lufta (panvarësisht e deklaruar apo jo), invadimi, lufta civile, rebelimi, revolucioni, trazira publike, eksodi, greva, kryengritja, grushti i shtetit, ndërprerja e punës nga punëdhënësi (lockout), aktet keqdashëse të një ose më shumë personave që veprojnë të nxitur nga motive politike, konfiskimi, rekuizimi, prishjet e urdhëruara nga organet kompetente, revoltat, turbullirat civile, komplotet;
- 4.1.3 nga reaksionet bërthamore, radiacioni bërthamorë ose ndotjet radioaktive;

4.2 Përjashtime për dëme në punimet e siguruara të kontratës:

Ky sigurim nuk mbulon, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shtojcë të veçantë:

- 4.2.1 dëmet vijuese të çdo lloji duke përfshirë gjobat, humbjet, për shkak të vonësës ose prishjes së kontratës, etj.;
- 4.2.2 dëmet për shkak të projektit të gabuar;
- 4.2.3 dëmet për shpenzimet e zëvendësimit, riparimit ose rregullimit të punëve të kryera me materiale difektoze, por ky përjashtim nuk do të shtrihet për punët e ndërtimit të kryera brenda standardeve, të cilat dëmtohen nga ndikimi i drejtpërdrejtë dhe i jashtëm i materialeve difektoze;
- 4.2.4 dëmet e amortizimit, grryerjes, oksidimit, rënies së cilësisë së materialeve për shkak të mospërdorimit dhe kushteve normale atmosferike;
- 4.2.5 dëmet për shkak të ndërprerjeve mekanike ose elektrike, ose daljes jashtë përdorimit të pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit;
- 4.2.6 dëmtimin e mjeteve motorike të pajisura me leje qarkullimi rrugorë, avionëve e anijeve;
- 4.2.7 dëmtimin e çeqeve, monedhave, sendeve të çmuara dhe të gjitha llojet e dokumentave;
- 4.2.8 dëmin e zbuluar vetëm gjatë kohës së kryerjes së inventarit.

4.3 Përjashtime për dëme të përgjegjësisë civile ndaj palëve të treta:

Ky sigurim nuk mbulon:

- 4.3.1 dëmtimet e çdo pasurie, toke ose ndërtese shkaktuar nga vibrimet ose nga lëvizja ose dobësimi i bazës mbështetëse ose plagosja ose dëmtimi i çdo personi ose pasurie të shkaktuar ose rrjedhur nga një dëm i tillë;

- 4.3.2 dëmtimet trupore ose sëmundjet e të punësuarve të zbatuesit ose investitorit ose ndonjë firme tjetër nënkontraktore të lidhur me projektin e ndërtimit. Ky përjashtim është i vlefshëm edhe për pjesëtarët e familjeve të tyre;
- 4.3.3 dëmtimet e pasurisë që i përkasin, mbahen në ruajtje, kontroll apo kujdes nga zbatuesi, investitori, porositi ose ndonjë firme tjetër nënkontraktore e lidhur me projektin e ndërtimi/montimit. Ky përjashtim është i vlefshëm edhe për të punësuarit e subjekteve të mësipërm;
- 4.3.4 dëmtimet e shkaktuara nga çdo aksident nga mjetet motorike të pajisura me leje qarkullimi rrugor, mjete ajrore ose mjete lundruese.

Neni 5, Afatet e kontratës

- 5.1 Afati i vlefshmërisë të kontratës fillon në orën 24.⁰⁰ të ditës së përcaktuar në policën si ditë e fillimit të periudhës së mbulimit dhe përfundon në orën 24.⁰⁰ të ditës të përcaktuar si ditë e përfundimit të saj.
- 5.2 Periudha e mbulimit në sigurim sipas këtyre kushteve të përgjithshme shtrihet në përputhje me kohën e nevojshme të përcaktuar teknikisht për realizimin e projektit përkatës.
- 5.3 Periudha e mbulimit mund të zgjatet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve (shtojcë - kontratat) për një periudhë mirëmbajtjeje të thjeshtë ose të zgjeruar të objektit tashmë të përfunduar.
- 5.4 Në rastet kur objekti i siguruar, ose pjesë e tij, përfundojnë (në datën e marrjes në dorëzim ose vënies në shfrytëzim), përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, atëherë përfundon automatikisht edhe periudha e mbulimit për objektin e përfunduar ose atë pjesë të tij që ka përfunduar.
- 5.5 Në qoftëse zbatimi i projektit të ndërtimit nuk përfundon brenda periudhës së mbulimit të kësaj kontrate, kjo e fundit, me kërkesën e të Siguarit, mund të zgjatet edhe për një periudhë tjetër kohe. Kërkesa për zgjatjen e periudhës së mbulimit duhet t'i paraqitet Siguruesit përpara përfundimit të periudhës së mbulimit të përcaktuar në policë.
Periudha e mbulimit shtesë është e vlefshme vetëm me miratimin e Siguruesit dhe kundrejt pagimit të primit shtesë nga i Siguarari.

Neni 6, Lidhja e kontratës së sigurimit

- 6.1 Kontrata e sigurimit lidhet në bazë të paraqitje së kërkesës me shkrim nga i Siguarari, e cila është pjesë përbërëse e saj, si dhe në bazë të rezultateve të inspektimeve paraprake të kryera nga Siguruesi në objektin dhe dokumentet përkatës të projektit të dhënë.
- 6.2 Kontrata e sigurimit nga rreziqet inxhinjrike quhet e lidhur, kur polica e sigurimit i dorëzohet të Siguararit, mbasi ky i fundit të ketë paguar primin e sigurimit ose këstin e tij të parë.

Neni 7, Shuma e siguruar

- 7.1 Shuma e siguruar do të përcaktohet:
- **për punimet**, në bazë të vleftës së plotë të kontratës duke përfshirë të gjitha materialet, pagat, transportin, taksat doganore;
 - **për makineritë dhe pajisjet**, në bazë të vlerës së zëvendësimit të tyre me të tjera të të njëjtit lloj dhe kapacitet;
 - **për pastrimin e mbeturinave** me rastin e ndodhjes së një dëmi të mbulueshëm, në përputhje me vlerën totale të punimeve të preventivuar (2 - 5% të saj);

- **për përgjegjësinë ndaj palëve të treta**, sipas marrëveshjes së palëve duke përcaktuar kufijtë e mbulimit në police për çdo një ngjarje sigurimi dhe seri dëmsh të shkaktuara nga një ngjarje e vetme;
 - **për fitimin e munguar**, sipas marrëveshjes së palëve.
- 7.2 I Siguarari duhet të njoftojë Siguruesin për çdo ndryshim të vleftës të punimeve, që ndodh gjatë periudhës së mbulimit që vjen si rrjedhojë e ndryshimit të çmimeve të materialeve të ndërtimit, pagave të punës, tarifave etj.
Me marrjen e njoftimit, Siguruesi jep miratimin me shkrim (ose jo) dhe bën kur është e nevojshme shënimet përkatëse në policën e sigurimit.
- 7.3 Pas pagesës së çdo dëmshpërblimi përgjatë periudhës së mbulimit të kësaj kontrate, objektet ose pjesë të tyre mbeten të siguruar deri në përfundim të periudhës së mbulimit, për diferencën midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar, duke bërë për këtë shënimet përkatëse në policën e sigurimit.
- 7.4 Shuma e sigurimit, me marrëveshje të palëve, mund të riaktivizohet në vlerën e saj të plotë pas çdo dëmshpërblimi, kundrejt pagimit të një primi shtesë.

Neni 8, Primi i sigurimit

- 8.1 Primi i sigurimit është funksioni i shumës së sigurimit kumulative ose përgjegjësisë maksimale në përputhje me faktorët e përcaktimit të tarifës përkatëse.
- 8.2 Paga e primit të sigurimit (ose këstit të parë të tij) quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit në monedhën e përcaktuar në Policën e Sigurimit.
Kësti i fundit duhet të paguhet jo më vonë se 3 muaj nga data e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës.
- 8.3 Kur i Siguarari nuk paguan primet (këstet) në vazhdim sipas afateve të maturimit të pagesës, mbulimi në sigurim pezullohet deri në orën 24.00, të ditës së pesëmbëdhjetë duke filluar nga data e maturimit të këstit të rradhës të papaguar. Humbjet dhe dëmtimet e vertetuara brenda afatit të mësipërm dëmshpërblehen vetëm pasi të jetë zbritur shuma e papaguar e kësteve të maturuar.
- 8.4 Pas kalimit të afatit të mësipërm, kontrata konsiderohet e zgjidhur automatikisht pa detyruar Siguruesin që të bëjë njoftim të veçantë të Siguararit, përveç njoftimit të bërë atij, për t'i kujtuar detyrimin për të paguar në kohën e përcaktuar në policë.
Çdo humbje dhe dëmtim i vërtetuar që ka ndodhur pas këtij afati është i pambulueshëm.

Neni 9, Mbisigurimi dhe nënsigurimi

9.1 Mbisigurimi:

- Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën reale të projektit, atëherë si Siguruesi ashtu edhe i Siguarari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar duke bërë korrektimet e nevojshme të primit të sigurimit.
- Në çdo rast i Siguarari nuk mund të përfitojë dëmshpërblim në vlerë më të madhe se humbja e pësuar nga ngjarja e sigurimit, cilado qoftë shuma e siguruar e shënuar në policën e sigurimit.
- Nëse i Siguarari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

9.2 Nënsigurimi:

- Nëse shuma e siguruar e llogaritur në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit është më e ulët se vlera reale e projektit, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me

koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar të shënuar në policë ndaj vlerës reale të projektit.

Neni 10, Pjesa e zbritshme dhe franshiza

10.1 Në policat e sigurimit të rreziqeve inxhinjrike, si rregull do të aplikohet pjesë e zbritshme dhe franshizë.

Siguruesi nuk do të trajtojë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë.

10.2 Për çdo rast dëmi të trajtueshëm, Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit, si përqindje mbi çdo një dëm ose seri dëmsh, të shkaktuara nga një ngjarje e vetme sigurimi.

Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizës përcaktohen në Policën e Sigurimit.

Neni 11, Detyrimet e të Siguruarit

I Siguruarit është i detyruar:

- në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit, të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat janë thelbësore, nëse ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë në atë kontratë. Nëse i Siguruarit me qëllim nuk e përmbush këtë detyrim, Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë primin e sigurimit, shumën e sigurimit si dhe të zgjidhë kontratën e sigurimit; Vërtetësia e deklarimeve të tij është kusht paraprak për çdo përgjegjësi të Siguruesit.
- të zbatojë rekomandimet e Siguruesit, si dhe të tregojë përkujdesjen e duhur për parandalimin e demit dhe minimizimin e tij, kur dëmi ka filluar;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të përdorë standardet e miratuara shtetërore ose ndërkombëtare në zbatimin e projektit;
- pas plotësimit të kërkesës për sigurim të mos kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin të Siguruesit, si dhe të informojë menjëherë me shkrim Siguruesin për çdo shtim të rrezikut të mëvonshëm për të cilin vihet në dijeni, edhe nëse një shtim i tillë ndodh pa pëlqimin e tij. Në rast të mosnjoftimit të Siguruesit, ky i fundit çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit;
- të lejojë Siguruesin të kryejë inspektimet e nevojshme në objektin e siguruar.

Neni 12, Dëmshpërblimi, procedura, detyrime të palëve

12.1 Në rastin e ndodhjes së një dëmi ose me vërtetimin e përgjegjësisë, i Siguruarit duhet:

- të njoftojë menjëherë Siguruesin me shkrim duke i dhënë njoftim për natyrën dhe shtrirjen e demit. Menjëherë në kuptimin e këtij neni do të thotë brenda 48 orëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit ose marrja e dijeni për të;
- të marrë të gjitha masat për të pakësuar dëmet;
- të ruajë pjesët e prekura nga dëmtimi në mënyrë të tillë që të mund të inspektohen nga Siguruesi ose përfaqësuesi i tij.
- të japë të gjithë informacionin dhe provat dokumentare që kërkohen nga Siguruesi;
- të informojë organet përgjegjëse ligjore të Ministrisë së Rendit dhe Prokurorisë në rastet e dëmtimit të objekteve të siguruar, të shkaktuara nga vjedhje ose grabitja;

- t'i paraqesë Siguruesit një kërkesë me shkrim ku të përcaktohen objektet e siguruar që janë riparuar ose zëvendësuar dhe gjithë dokumentacionin që verteton kryerjen e riparimeve ose zëvendësimeve të tilla.

- të provojë ndodhjen e rastit të sigurimit.

12.2 Nëqoftëse Siguruesi ose përfaqësuesi i tij nuk kryejnë inspektimin brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, i Siguruarit ka të drejtë të fillojë riparimet ose zëvendësimet e nevojshme.

12.3 Në rastin e ndodhjes së një dëmi ose me vërtetimin e përgjegjësisë së të Siguruarit, Siguruesi duhet:

- të dëmshpërblejë të Siguruarin me anë të pagesës, zëvendësimit ose riparimit (sipas zgjedhjes së Siguruesit) brenda shumës së siguruar ose kufirit të dëmshpërblimit përkatësisht 30 ditë pasi të jetë dorëzuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe i kërkuar për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit dhe vlerësimin e demit.

- të kryejë inspektimin e demit brenda 14 ditëve nga data e njoftimit të rastit të demit nga i Siguruarit.

12.4 Siguruesi ka të drejtë të shtyjë pagesën e dëmshpërblimit:

- për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit për t'u dëmshpërblyer;
- në qoftë se ka filluar çështje penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj të Siguruarit ose njërit prej të punësuarve të tij, deri në përfundimin e një procedure të tillë;
- për aq kohë sa i Siguruarit nuk paraqet dhe nuk plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi;

Neni 13, Çlirimi nga detyrimi i Siguruesit

13.1 Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për të dëmshpërblyer të Siguruarin, në qoftëse kërkesa për dëmshpërblim përmban elemente mashtrimi ose në qoftëse faktet janë pasqyruar në mënyrë të rreme në mbështetje të mashtrimit ose të zmadhimit thelbësor të masës së demit.

13.2 Siguruesi në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për dëmin ose përgjegjësinë për të cilat ai nuk ka marrë nga i Siguruarit asnjë njoftim brenda 14 ditëve nga ndodhja e tyre.

13.3 Siguruesi nuk dëmshpërblen shpenzimet e riparimit të zakonshëm të cilat nuk rrjedhin dhe nuk janë pasojë e një ngjarje sigurimi.

Neni 14, Ndryshimi dhe zgjidhja e kontratës

14.1 Efektet juridike dhe financiare të kësaj kontrate ndryshohen me mirëkuptimin e palëve, nëpërmjet nënshkrimit të çdo shtojce të nevojshme.

14.2 Kjo kontratë nuk zgjatet në heshtje.

14.3 Palët në këtë kontratë me njoftim paraprak me shkrim prej 30 ditësh mund ta zgjidhin në mënyrë të njëanshme atë.

Neni 15, Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjes, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar policia e sigurimit.